



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1558/Prot.
1

Tiranë, më 04.6.2025

URDHËR

Nr. 08, Datë 02.06.2025

"Për shpalljen e datës për zhvillimin, e raundit të dytë të zgjedhjeve për autoritetin Drejtues në Departamentin e Gjuhës Spanjolle në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës"

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 36, pika 7 dhe neni 45, pikat 1, 2 dhe 3; Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës, si dhe përzgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve të Përhershme në Universitetin e Tiranës" neni 4, pika 9, 10 dhe 12; në zbatim të pikës 1 dhe 2, të Urdhrit nr. 105, datë 13. 03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në vijim të Urdhri i Rektorit të UT-së nr. 06, datë 22.04.2025, "Për fillimin e procesit zgjedhor për zgjedhjen e autoritetit drejtues "Përgjegjës i Departamentit të Gjuhës Spanjolle", në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT-së, dhe përcaktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për këtë autoritet drejtues", rezultateve të shpallur, datë 26.05.2025 të KZ-së së Fakultetit të Gjuhëve të Huaja,

URDHËROJ:

1. Zhvillimit e raundit të dytë të zgjedhjeve për autoritetin Drejtues, në Departamentin e Gjuhës Spanjolle në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, më datë 16.06.2025.
2. Ngarkohen Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Fakulteti i Gjuhëve të Universitetit të Tiranës, për zbatimin e këtij Urdhri.
3. Ky urdhër i përcillet për njohjen dhe zbatim, Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Fakultetit të Gjuhëve të Huaja dhe publikohet në faqen zyrtare dhe ambientin e dedikuar për publikim në Universitetin e Tiranës dhe Fakultetit, të përcaktuar në këtë urdhër.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof. Dr. Artan Hoxha

